

# ***SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME***

***Objekti: Blerje materiale te ndryshme, Bashkia Mat***

## **NJËSITË MATËSE**

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë Celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

## **FURNIZIMI ME MATERIALE**

**Çdo materiale qe do te furnizohet do të futet paraprakisht në magazinën e bashkise, ku do të kontrollohet për cilësinë dhe specifikimet teknike të kërkuara më poshtë. Pasi verifikohet që materiali plotëson kriteret e kërkuara, mund të bëhet dalje nga magazina dhe të vendoset në objekt sipas kërkesës.**

## **PUNIME TË GABUARA**

Çdo material që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta.

- 1. Llaç bastard marka 1:2** me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, rërë në raporte 1:2. Çimento 527 kg (tipi 400). rërë m<sup>3</sup> 0,89.

Dozaturat e mësipërme janë të vlefshme për 1(një) m<sup>3</sup> llaç. Ato janë marrë nga Manuali Nr. 1 “Analiza teknike për prodhimin e materialeve të ndërtimit, këshilla dhe udhëzime”, të Datuar në Dhjetor 1992, Tiranë (Republika e Shqipërisë - Ministria e Ndërtimit).

## **2. SKELAT**

**2.a** Skela metalike tubolare e tipit kavalet, e ndërtuar sipas normave teknike në fuqi, përfshirë ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjet në vepër, mbërthimin, çmontimin etj., për një lartësi deri në 12m, duke përfshirë përforcimin me pahi, dhe të formuar nga dërrasa me trashësi 5cm, për një rradhë të vetme të skelës dhe nënskelës, parmakun, telat mbrojtës dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për sigurimin e punëtorit. N.q.s është e nevojshme rrethimin e skelave të jashtme nga ana e rrugës, me anë të llamarinës së valëzuar, të larta jo më pak se 2m, duke përfshirë firot, hapjet në terren për mbështetjen e këmbëve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave në këmbët, në bordet e poshtme dhe të sipërme, për të gjithë kohëzgjatjen e

skelës në vepër, çmontimin dhe heqjen në fund të punës, duke përfshirë shenjat e mundshme, tabelat dhe dritat.

**2.b** Skelë metalike tubolare, e montuar me tuba të rrumbullakët dhe lidhje, e ndërtuar sipas normave teknike në fuqi, përfshirë ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjet në vepër, mbërthimin, çmontimin etj., për një lartësi deri në 12m, duke përfshirë përforcimin me pahi, dhe të formuar nga dërrasa me trashësi 5cm, për një rradhë të vetme të skelës dhe nënskelës, parrmakun, telat e mbrojtjes dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për sigurimin e punëtorit. N.q.s është e nevojshme rrethimin e skelave të jashtme nga ana e rrugës, me anë të llamarinës së valëzuar, të larta jo më pak se 2m, duke përfshirë firot, hapjet në terren për mbështetjen e këmbëve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave në këmbët, në bordet e poshtme dhe të sipërme, për të gjithë kohëzgjatjen e skelës në vepër, çmontimin dhe heqjen në fund të punës, duke përfshirë shenjat e mundshme, tabelat dhe dritat.

**2. c** Skelë dërrase, e montuar me binarë dhe dërrasa, e ndërtuar sipas normave teknike në fuqi, përfshirë ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjet në vepër mbërthimin, çmontimin etj ., për një lartësi deri në 12m, duke përfshirë përforcimin me pahi, dhe të formuar nga dërrasa me trashësi 5 cm, për një rradhë të vetme të skelës dhe nënskelës, parrmakun. telat e mbrojtjes dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për sigurimin e punëtorit.

N.q.s është e nevojshme rrethimin e skelave të jashtme nga ana e rrugës, me anë të llamarinës së valëzuar, të larta jo më pak se 2m, duke përfshirë firot, hapjet në terren për mbështetjen e këmbëve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave në këmbët, në bordet e poshtme dhe të sipërme, për të gjithë kohëzgjatjen e skelës në vepër, çmontimin dhe heqjen në fund të punës, duke përfshirë shenjat e mundshme, tabelat dhe dritat.

### **3. HEKURI I NDËRTIMIT**

Hekuri i ndërtimit për të gjitha strukturat e përforcuara të betonit dhe materialeve me përbërës hekuri që prodhohen në shesh duhet që hekuri të plotësojë këto kërkesa:

Tipi C-3, me  $R_a=2.100 \text{ kg/cm}^2$  dhe pa ndryshk, me masa dhe forma në përputhje me vizatimet dhe standartet teknike legale për hekurat e punës, bashkimet etj., dhe të jenë të shoqëruara me një çertifikatë që të vërtetojë që hekuri përmbush të gjitha kërkesat për punën që do të kryhet.

### **4. DRITARE DURALUMINI**

Furnizimi i dritareve duroalumini, me profil italian, xham transparent me trashësi 4mm. Forma do të jetë sipas vendit ku do të instalohet. Për të vendosur xhamat do të përdoret gomina tubolare dhe për izolimin rrotull kornizës në kontakt me murin do të përdoret selikon i tipit 1013.

### **5. DYER TË BRENDSHME**

Furnizimi i dyerve, për të cilat përmasat do të merren te kontraktuesi janë me kornize alumini italiane e kombinuar me melamin me trashësi 8mm dhe kornizë metalike 2mm. Brava do të fiksohet në një profil alumini i cili do të jetë paralel me dyshemenë (rreth 1m nga dyshemeja).

### **6. TUBA TE BRINJEZUAR**

Tuba të brinjëzuar për përdorim në kanalizime ujrash të bardha dhe të zeza, drenazhime, mbrojtje, kabllorsh elektrike, telekomunikacioni etj. Tub të strukturuar prej polietileni me dendësi të lartë me parete të dyfishta sipas standardit prEN 13476-1 TIPI B sipas të cilit pareti i brendshëm është lisho dhe pareti i jashtëm është i strukturuar. Tubat prodhohen nga prodhues i çertifikuar me ISO 9001:2000. Tubat të bashkohen me njëri - tjetrin sipas metodës me një manikotë + 2 guarnicione prej gome. Manikotat janë me parete të jashtëm të strukturuar dhe me një pengesë në mes të saj sipas EN13476-1 2000 dhe gominat prodhohen sipas standardit EN 681.

- Diametri jashtëm : 500 mm, 315 mm
- Dendësia : SN4( $\geq 4$  KN/m<sup>2</sup>)
- Materiali : HDPE
- Gjatësia : 6 m

## **6. DERRASA, BINARE**

Derrasa, binare, sipas kerkesave, duke ofruar garanci dhe cilesi.

- Përmasa : sipas kerkeses perfundimtare
- Gjatësia : 4 m

## **7. ELEKTRODA SALDIMI**

Elektrodë saldimiti hekur ESR, 13M, 3.2x350 mm. Elektrodat janë një element kyç në bashkimin e elementëve metalikë.

- Gjatësia : 350mm
- Diametri : 3.2mm
- Përdorimi : Metal
- Sasia e paketimit : 2.5kg

## **8. CIMENTO**

Cimento me cilësi superiore, prodhuar sipas standarteve Europiane, çertifikuar CE.

- Përdorimi : Per llac
- Paketimi : 25kg/thes
- Tipi : 42.5 R

Duhet te jete “Portland” ,M400 ne thase 50kg. dhe ne perputhje me kushtet e Standartit Shteteror STASH-501-87.

Çertifikata e cilesise dhe fletet e analizave te fabrikave qe kane prodhuar çimenton duhet te shoqerojne cdo furnizim sipas porosise se entit kontraktor, duke vertetuar qe çimentoja eshte e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Transporti ne objektet e Bashkise ose magazine duhet te behet nga kontraktori ne paketa origjinale te shenuara direkt nga fabrika e prodhimit te çimentos dhe te rruajtura ne kushte te duhura.

## **9. RRJETE TELI**

Rrjetat qe të shërbejnë si dekorime gardhe, porta etj.

- Tipi : Rrjete Saldim
- Diametri : 1.6 mm
- Gjerësia : 1.2ml
- Gjatësia : 25ml
- Përmasa : 1.2x25 ml
- Materiali : Xingato
  
- Përmasa : 1x20 ml
- Diametri : 1.6 mm
- Materiali : Xingato

## **10. TEL BARI**

Teli i bari qe sherben per te lidhur strukturat e armatures se hekurit, per te lidhur rrjetat e telit ne kollonat mbajttese.

- Materiali : Hekur
- Diametri : 1.2 mm
- Pesha : 20 kg/ruloni

## **11. BORDURAT**

Bordurat per gjatë rrugëve të makinave edhe trotuarëve, në parqet edhe oborret, rreth luleve.

- Përmasa : 15x100cm
- Lartësia (cm) : 25cm
- Ngjyra : Gri

- Përmasa : 12x100cm
- Permasa 12x 25 cm
- Permasa 15x 25 cm
- Permasa 15x 30 cm
- Permasa 15x 35 cm
- Permasa 20 x 35 cm
- Permasa 25 x 35 cm
- Lartësia (cm) : 17cm
- Ngjyra : Gri
- Përmasa : 12x100cm
- Lartësia (cm) : 20cm
- Ngjyra : sipas kerkeses perfundimtare

## 12. PLLAKAT E TROTUARIT

Pllakat e trotuarit të presuara gjatë prodhimit, perbehen nga përzierja rërë-çimento e cila i është nënshtruar vazhdimisht goditjeve konstante me çekiç të specializuar. Krejt procesi i ngurtësimit së betonit ndodh nën presionin e lartë brenda formës. Pllaka e gatshme është në fakt një gurë artificial me fakturen edhe pamjen e saj të veçantë. Siperfaqe jo e lustruar, me pore, cka e ben perfekte për fushat me lëvizje aktive si te njerëzve edhe te transportit. Pllaka e presuar karakterizohet me rezistencete larte jo vetëm ndaj ndikimeve fizike. Struktura e saj poroze i lejon pllakës të “marrë frymë”, karakteristike e cila rrit numrin e cikleve të ndryshimeve të temperaturës. Raporti i ulët i ujit-çimentos tregon një imunitet ndaj sulmit kimik të mjedisit. Pllakat e betonit jane një zgjidhje perfekte për ambiente me lëvizje te ngarkuar

- Përmasa : 20x10 cm, 40 x 40 cm, forme T, etej sipas kerkeses perfundimtare.
- Trashësia : 6 cm
- Metra katror për lidhje (m<sup>2</sup>) : 15.42 m<sup>2</sup>/palet

Parametra teknik.

1. Permasat e pllakave te betonit 200x100x60 mm dhe kerkesave te detajuara gjate furnizimit
2. Tipi I kokrrizes dhe permasa e pjesezes 5- 10 mm
3. Masa ne (g) 2900 g
4. Rezistenca ne perkulje ( N/ mm<sup>2</sup> ) jo me e vogel se 7 N/ mm<sup>2</sup>
5. Ujethithja % 5.51 %
6. Ngarkesa e shkaterrimit ne N , jo me e vogel se 14 000 N
7. Pllakat e betonit duhet te jene me shtrese kuarci per rezistencen nga temperaturat.
8. Pllakat e betonit do te jene me 2 ngjyra, 1635 m<sup>2</sup> do jene me ngjyre te zeze, 3265 m<sup>2</sup> do te jene me ngjyre gri ( ngjyra e betonit ) .

## 13. KAPAK GIZE

Kapaket e gizes janë projektuar për të kombinuar forcën e lartë dhe peshën e lehtë dhe përfshijnë veçori të tjera të tilla si një labirint i vetme i vulave dhe përmirësime të sigurisë. Një nyje e patentuar e sigurisë parandalon shkëputjen aksidentale gjatë ngritjes operacion. Përfshin një marrëveshje të vetme të labirintit të vulës për të ndihmuar në parandalimin e arratisjes së aromave dhe hyrjes së ujit. Prodhuar nga hekuri i butë dhe i fortë

- Materiali : Gize
- Përmasa : te ndryshme sipas kerkeses
- Kapaciteti mbajtës : 12.4 ton

#### **14. LLAC MBUSHES**

Llaç mbushës themelor me bazë gipsi, me përmbajtje polimerësh dhe aditivësh special për mure tulle ose blloku për ambiente të brendshme. Material në formë pluhuri me bazë gipsi, gelqere e hidratuar, granulometri të seleksionuar rezina sintetike dhe adetive special për aplikime në ambiente të brendshme.

- Pa rrëshkitshmeri vertikale.
- Punueshmëri shumë të mirë.
- Ngjitje shumë e mirë nëpër mure dhe tavane.
- Rezistence e lartë mekanike.
- Konform EN 998-1

- Ngjyra : gri
- Ruajtja : 12 muaj në paketim origjinal në vend të thatë
- Djegshmëria : 0
- Raporti i përzierjes : 6-6.5 litra ujë për 25 kg
- Temperatura : 5 gradë deri në +35 gradë
- Koha e punueshmërisë : 2 ore
- Rezistenca në shtypje :  $> 3 \text{ N/mm}^2$
- Rezistenca në përkulje :  $\geq 1.5 \text{ N/mm}^2$

#### **15. KATRAMA**

Karton katrama është një membrane hidroizoluese prej bitumi me cilësi të lartë të modifikuar me polimere dhe të përforcuar me poliester ose tekstil me fije qelqi me trashësi të ndryshme.

- Sasia e paketimit : 1 rol/10m<sup>2</sup>
- Tipi : Me granil, pa granil
- Dendësia : 4kg/m<sup>2</sup>
- Trashësia : 4mm

Karton katrama është një membranë ideale për hidroizolim e kulmeve, themelet, bodrumet dhe bazamentet, tavaneve etj . Gjithashtu mund të përdoret për hidroizolim e ujit të tarracave, zonave të lagështta etj. Ofron një pengesë pozitive për ujin dhe avullin. Te kete rezistencë të shkëlqyer ndaj agjentëve atmosferikë. Fleksibilitet të lartë në temperatura të ulëta. Ruan stabilitetin e formës në temperatura të larta. Aftësitë e larta të performancës i bëjnë të mundur përballimin e goditjeve termike. Përshtatet ne lëvizje strukturore.

- Përmasa e rullit : 10m<sup>2</sup>
- Trashësia : 4mm
- Përdorimi : Hidroizolim

## 16. TULLA

Tulla qeramike per mure te shtëpive, pallatit.

- Materiali : Qeramike
- Përmasa : 20x25x25cm,
- Materiali : Qeramike
- Përmasa : 12 x 20 x 25cm
- Tipi : Ndarese

- **INERTET**

## 17. RERE

**Rere guri dhe çakell makinerie** e prodhuar nga thyerja dhe fraksionimi ne makineri I materialeve gurore ose zhavorre lumi me fortesi **800 kg/cm<sup>2</sup>** dhe te respektoje kushtet teknike te **Standartit Shqiptar STASH-512-78** dhe te mos kete permbajtje te huaj argjilore me shume se **5%** dhe material organike jo me shume se **3%**. Rera e makinerise duhet te kete granulometrine (0-5)mm,ndersa çakelli i makinerise (20-60)mm.

### **Te pergjithshme**

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale”. Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kte perforcim.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet te njohura per te arritur

rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

### **Inertet e imta**

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera.

Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percakuar nga Mbikqyresi i Punimeve.

Masa e Sites Perqindja qe kalon (peshe e thate)

10.00mm 100

5.00mm 89 ne 100

2.36mm 60 ne 100

1.18mm 30 ne 100

0.60mm (600 um) 15 ne 100

0.30mm (300 um) 5 ne 70

0.15mm (150 um) 0 ne 15

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

### **Inertet e trasha**

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)

50.0 mm 100

37.5 mm 90 ne 100

20.0 mm 35 ne 70

10.0 mm 10 ne 40

5.0 mm 0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej



tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

### **Raportet e inerteve te trasha dhe te imta**

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla.

Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

## **18. TOMBINOT**

### **TOMBINOT Ø400mm, Ø 600mm, Ø800mm**

**Tombinot** duhet te jene rrethore me dimensionet e mesiperme qe i korespondon diametrit te brendshem, duhet te perballojne ngarkesat e levizshme **N-18 dhe T-80** dhe te prodhohen ne perputhje me **Standartin Shteteror ne fuqi STASH-2503-87**. Tombinot me diameter 400mm dhe 600mm jane betoni ndersa ato me diameter 800mm jane beton-arme dhe tashesi te pareteve  $t=10\text{cm}$ .

## **19. STABILIZANTI**

Te jete i prodhuar nga materiale gurore i thyer ,i fraksionuar dhe te plotesoje kerkesat e meposhteme:

- Fortesia e gureve perberes  $\geq 800\text{kg/cm}^2$
- Marka e thermimit nga prova Losanxhelos  $LA \leq 30\%$
- Permbajtja e argjiles deri ne 5% dhe materialeve organike deri ne 3%

## **20. BINDER**

Te jete i prodhuar nga material gurore i thyer me permasat nga 5-20mm. me permbajtje bitumi jo me pak se 4.5% ,densiteti  $2.2\text{gr/cm}^3$  dhe bitum 50 70. Materiali i gurit qe do te perdoret per granilin e gurit, si perberes e binderit duhet duhet te jete me marke me te madhe se  $800\text{kg/cm}^2$ . Temperatura e binderit ne ne momentin e hedhjes ne objekt duhet te jete 150 grade.Ne perzierjen e gatshme te binderitr nuk lejohet te kete kokrriza te pa mbuluara me bitum.

## **21. HEKUR**

**Zgare hekuri per shtresa betoni ne rruge** duhet te jete me hekur  $\text{Ø}4\text{mm}$  dhe me permasa te zgares

**(4.70\*2)m.si dhe me permasa te kuadratit te zgares (25\*25)cm.**

## **22. DERRASA**

**Derrasa duhet te jete 5cm.** e stazhionuar , e skuadruar dhe pa plasaritje, e vendit dhe me gjatesi  $L=(3.5 \div 4)\text{m}$ . Sasia e derrases se dorezuar tek bleresi duhet te shoqerohet me çertifikaten e cilesise se mallit te leshuar nga subjekti prodhues.

## **23. Dyer dhe dritare**

Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërteses. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre

variojnë, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Dritaret duhet të jenë në kuotë 80-90 cm mbi nivelin e dyshemesë, kjo varet dhe nga kërkesat e projektuesit.

Dritaret mund të jenë të prodhuara me dru, alumin ose PVC. Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatimin teknik, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në te. Kanate me xhama të hapshëm, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikoni, si dhe me kanata fikse.

Dritaret e përbëra me profil duralumini i kemi me:

Hapje vertikale

Hapje horizontale

Me rreshqitje

dhe janë të përbëra nga:

Korniza e fiksuar e aluminit (me përmasa 61-90mm) do të jetë e fiksuar në mur me telajo hekuri të montuara përpara suvatimit. Dritaret janë të pajisura me elemente, që shërbejnë për ankorimin dhe fiksimin e tyre në mur si dhe pjesët e dala, që shërbejnë për rrëshqitjen e kanatit të dritares.

Kanati i dritares do të vidhohet në kornizën e dritares mbas punimeve të suvatimit dhe bojatisjes. ulluqet e mbledhjes së ujit

Aksesorët

rrota për rrëshqitjen e tyre dhe korniza e grilave

përforcues hekuri

ulluk prej gome

doreza dhe bllokues të ankoruar në të

panel me xham të hapshem (4 mm të trashë kur është transparent, 6 mm kur janë të përforcuar me rrjet teli ose dopio xham). Ato do të fiksohen në kornizat metalike nga listela alumini dhe ngjitës transparent silikoni

**Pragjet e dritareve** janë dy llojesh: pragje të brendshme dhe të jashtme. Ato mund të jenë me material granili të derdhur, me pllakë mermeri ose me pllakë granili me ngjyrë dhe me pikë kullim uji, sipas vizatimit teknik ose udhezimeve të supervizorit. Pragjet do të kenë kënde të mprehta dhe çdo

detyrim tjetër për përfundimin e punës.

### **Dritare duralumini**

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilat janë sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra e dritares do të jetë sipas

kërkesës së investitorit.

Korniza fikse e dritare do të ketë një dimension 61-90mm. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i kanates të dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension: gjërësia 32 mm dhe lartësia 75 mm të sheshta ose me zgjedhje ornamentale. Të dyja korniza fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë bërë me dy profile alumini të cilat janë bashkuar me njëra tjetrën dhe kanë një fugë ajri që shërben si thyerje termike, ato janë të izoluar nga një material plastik 15 mm. Profilet e aluminit do të jenë të lyera sipas procesit të pjekjes lacquering. Temperatura e pjekjes nuk duhet të kalojë 180 gradë, dhe koha e pjekjes do të jetë më pak se 15 minuta. Trashësia e lacquering duhet të jetë së paku 45 mm. Pudrosja e përdorur do të bëhet me resins acrylic te cilesisë së larte ose me polyesters linear.

Spesori i duraluminit duhet të jetë minimumi 1,5 mm. Panelet e xhamit (4mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të përforcuara me rrjet teli ose me dopio xham). Ato do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të dritares dhe të shoqëruara me gomina. Të gjitha punët e lidhura me muraturen dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me kujdes. Një model i materialeve të propozuara do të shqyrtohet nga supervizori për një aprovim paraprak.

### **Dyert - informacion i përgjithshëm**

Dyert janë një pjesë e rëndësishme e ndërtesave. Ato duhet të sigurojnë hyrjen në pjesët e brendshme të tyre. Në varësi të funksionit që kanë, dyert mund të jenë të brendshme ose të

jashtme. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre janë të ndryshme në varësi të kompozimit arkitektonik, kërkesave të

## **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore në SUT për vitin 2017. Sasia e shërbimeve ( punimeve ) sipas zërave të punës, do të jetë sipas nevojave të SUT , të pasqyruara në situacione mujore të firmosura nga palët kontraktuese

### **24. Ndriculesit LED**

#### **KARAKTERISTIKAT KONSTRUKTIVE**

- Mbulesa e sipërme alumin e stampuar dhe e lyerj me boje polyester gri, RAL 7035, I papershkueshem nga pluhuri, rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe korrozionit, rezistente ndaj vibrimeve dhe goditjeve
- Trupi prej alumini I lyer me boje polyester gri
- Reflektori alumini me reflektim te larte 99.08%, I paoksidueshem me rrezatim cut-off
- Guarnicion gome me qendrueshmeri te larte
- Xham I temperuar I sheshte I vendosur nepermejt tubit dhe suportit
- Normativat e kerkuara: ME 4 A CE3 per ndricim rrugor, shkalla e mbrojtjes IP 67
- Lidhjet e percjellesave te behen me morseteri me kapuc
- Armatura e ndricimit tip LED: > ,ose =140 W

#### **DETAJE TE ARMATURES SE NDRICIMIT**

- Ndricules tip LED
- Tensioni 85-265v
- Fuqia totale e llamper jo me pak se 140W
- Temperatura e punes nga -40 deri 60°C
- Faktori I fuqise 95%
- Faktori I mbrojtjes IP 67
- Koha e punes 50.000 ore pune
- Eficensa e ndricimit te fluksit te llampes: 101 L/W
- Temperastura e ngjyrave 5000-6000K e bardhe
- Treguesi I dhenies se ngjyrave RI 75
- Standarti I sigurise ME 4A

- **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: Blerje materiale te ndryshme ndertimi. Sasia e shërbimeve ( punimeve ) sipas zërave të punës, do të jetë sipas nevojave të Bashkise Mat , të pasqyruara në situacione mujore të firmosuar nga palët kontraktuese.

**Specifikoi:**

**Ing. Etmond Lleshi**

**Ing. Arlind Mamica**